

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-197/13

**Prishtinë,
26 mars 2014**

Në çështjen juridike të:

**M V
R D 6
K,
G
S**

Paraqitësi i Kërkesës/Ankuesi

kundër.

Nuk ka

Pala përgjegjëse në kërkesë/ ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Esma Erterzi, Kryesuese e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/164/2012 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat: (KPA13978, KPA 50354, KPA 13979, KPA 13980, KPA 50355, KPA 13975, KPA 13976, KPA 50352, KPA 13977, KPA 50353,) i datës 5 shtator 2012, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 26 mars 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e M V, pranohen si të bazuara të paraqitura nga kundër vendimit të KPCC /D/A /164/2012 (lënda e regjistruar në KPA 13978, KPA 50354, KPA 13979, KPA 13980, KPA 50355, KPA 13975, KPA 13976, KPA 50352, KPA 13977, KPA 50353,) i datës 5 shtator 2012, pranohen si të bazuara.
- 2- Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164 /2012 i datës 5 shtator 2012 (lëndët e regjistruara në KPA 13978, KPA 50354, KPA 13979, KPA KPA 13980, KPA 50355, KPA 13975, KPA 13976, KPA 50352, KPA 13977, KPA 50353,) i datës 5 shtator 2012,
- 3- Hedhen poshtë kërkesat e M V nga Komunae Palilulës, R.Serbisë të cilat janë të regjistruara në AKP me numrat: KPA 13978, KPA 50354, KPA 13979, KPA 13980, KPA KPA 50355, KPA 13975, KPA 13976, KPA 50352, KPA 13977, KPA 50353, për shkak të mungesës së juridiksionit.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

- 1- Me 7 nëntor 2007 M V ka paraqitur 10 (dhjetë) kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP),duke kërkuar konfirmimin e së drejtës të ½ të pjesës ideale së bashkëpronësisë të disa ngastrave dhe ri-posedimin tyre. Ai ka shpjeguar se këto ngastra kadastrale kanë qenë në emër të tij dhe të cilat ishin uzurpuar.
- 2- Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Letërnjoftimin të lëshuar me datë 25 shtator 2007, nga organi kompetent i Komunës së Klinës.
 - Fleta Poseduese nr. 198 i datës 4 shkurt 2008 të lëshuar nga Drejtoria për kadastrë , gjeodezi dhe pronësi të Komunës së Klinës,
 - Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Klinë C.nr.319/96 i datës 17 mars 1998. Ky aktgjykim nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë.
- 3- Sipas fletë posedimit nr.198 të Drejtorisë për kadastrë, gjeodezi dhe pronësi të Komunës së Klinës, i datës 4.2.2008, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës të cilët gjenden në zonën

kadastrale Shtupel, Komuna e Klinës janë të regjistruara në emër të ndërmarrjes së bujqësore prodhuese “Malishgan” nga Klina dhe atë:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-197/13 (KPA13978)	Ngastra Nr.328/18, në vendin e quajtur “Parallova”, arë e klasës së 6-të, me sipërfaqe prej 01.31.13 ha
GSK-KPA-A-198/13 (KPA32818)	Ngastra Nr.328/18 në vendin e quajtur “Parallova”, arë e klasës së 6-të, me sipërfaqe prej 01.31.13 ha
GSK-KPA-A-199/13 (KPA32819)	Ngastra Nr.328/19, në vendin e quajtur ”Parallova” mal e klasit të 4-të, në sipërfaqe prej 3.36.17 ha
GSK-KPA-A-200/13 (KPA13980)	Ngastra Nr.328/22 në vendin e quajtur “Parallova” në sipërfaqe prej 0.74.01 ha, me kulturë mal e kalsës të 4
GSK-KPA-A-201/13 (KPA13979,13980 dhe 50355)	Ngastrat Nr.,328/19 dhe 328/22 janë të regjistruara si më lartë.
GSK-KPA-A-202/13 (KPA13975)	Ngastra Nr.328/20 në vendin e quajtur, “Parallova” në sipërfaqe prej 0.31.37 ha
GSK-KPA-A-203/13 (KPA13976)	Ngastra Nr.328/21, në vendin e quajtur, “Parallova” në sipërfaqe prej 0.64.35 ha,me kulturë mall, të kalasës së 4
GSK-KPA-A-204/13 (KPA500352)	Me kërkesën e tij i kërkon ngastrat kadastrale 328/20 dhe 328/21, të cilat janë të regjistruara me masa dhe përkufizime gjeometrike si më lartë.
GSK-KPA-A-205/13 (KPA13977)	Ngastra Nr.526/1, në vendin e quajtur “Parallova”, me kulturë mal i klasës së 4-të, në sipërfaqe prej 0.69.98 ha
GSK-KPA-A-206/13 (KPA500353)	Ngastra Nr.526/1, në vendin e quajtur “Parallova”, me kulturë mal i klasës së 4-të, në sipërfaqe prej 0.69.98 ha

- 4- Më vonë gjatë procedurës, Sekretaria ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës ka siguruar sipas detyrës zyrtare edhe certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme të lëshuar nga Zyra kadastrale e Komunës së Klinës me nr. të certifikatës UL-71006059-00306 i datës 15 janar 2009. Me këtë certifikatë konstatohet se të gjitha pronat e paluajtshme që janë objekt i kërkesës së paraqitësit të kërkesës janë të regjistruar në emër të NEWCO Malishgan toka Bujqësore Parallovë LLC në

qirambajtje për 99 vjet. Nga kjo rezulton se ,të gjitha këto ngastra kadastrale në procedurën e privatizimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit janë privatizuar dhe kjo pronë bujqësore është shndërruar në qirambajtje për 99 vjet për pronarin e ri. Në këtë certifikatë përfshihen të gjitha pronat e paluajtshme që janë objekt i kërkesës së paraqitësit të kërkesës.

- 5- Ekipi verifikues i Agjencisë Kosovare të Pronave sipas raportit të notifikimit dhe konfirmimit ka bërë notifikimin e ngastrave kadastrale që janë objekt i kërkesës edhe atë si më poshtë:
 - Sipas kërkesës së KPA 13978 që i referohet ngastrës kadastrale 328/18 është bërë notifikimi me 6 nëntor 2008 si dhe rinotifikimi me datë 21 korrik 2010 me ç ‘rast është konstatuar se kjo ngastër nuk ka qenë e uzurpuar ,
 - Sipas kërkesës së KPA 13979 që i referohet ngastrës kadastrale 328/19 është bërë notifikimi më 4 nëntor 2008 si dhe rinotifikimi më datë 21 korrik 2010 dhe se kjo paluajtshmëri nuk është gjetur e uzurpuar ,
 - Sipas kërkesës së KPA 13980 që i referohet ngastrës kadastrale 328/22 është bërë notifikimi më 6 nëntor 2008 si dhe rinotifikimi më datë 21 korrik 2010 dhe se ngastra kadastrale nuk është gjetur e uzurpuar,
 - -Sipas kërkesës së KPA 13975 që i referohet ngastrës kadastrale 328/20 është bërë notifikimi më 3 shtator 2007 si dhe rinotifikimi më 21 korrik 2010 dhe se ngastra kadastrale nuk është gjetur e uzurpuar,
 - -Sipas kërkesës së KPA 13976 që i referohet ngastrës kadastrale 328/21 është bërë notifikimi më 4 nëntor 2010 dhe rinotifikimi më 21 korrik 2010 dhe se ngastra kadastrale nuk është gjetur e uzurpuar,
 - -Sipas kërkesës së KPA 13977 që i referohet ngastrës kadastrale 526/1 është bërë notifikimi më 10 mars 2008 si dhe rinotifikimi më 28 maj 2010 dhe se ngastra kadastrale nuk është gjetur e uzurpuar.
- 6- Sipas raportit të verifikimit të Agjencisë Kosovare për prona i datës 10 tetor 2008 ,konstatohet se ekstrakti nga fletëposedimi nr. 198 i datës 29.4.2008 si dhe certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme të Zyrës kadastrale të Komunës së Klinës UL-71006059-00306 i datës 10.8.2008 janë verifikuar pozitivisht. Ndërkaq, sipas po të njëjtit Raport të verifikimit aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë, C.nr.319/96 datë 17.3.1998 ,nuk është verifikuar pozitivisht me arsyetim se ky aktgjykim nuk është gjetur në arkivin e kësaj Gjykate.
- 7- Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KKPK/D/A/164/12 datë 5 shtator 2012, ka refuzuar kërkesat e paraqitësit të kërkesave me arsyetim se ai dështoi të paraqesë prova juridikisht të vlefshme për të dëshmuar të drejtën e pronës së tillë. Ndërkaq, aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë,C.nr.319/96 datë 17.3.1998 me të cilën është anuluar kontrata e nënës së paraqitësit të kërkesës dhe Ndërmarrjes shoqërore “Malishgan” nga

Klina, nuk është verifikuar si e vërtetë, ngase nuk është gjetur në Arkivin e Gjykatës Komonale në Klinë. Po kështu, pronat që objekti i kërkesës sipas certifikatës për të drejtat e pronës së paluajtshme të Zyrës Kadastrale të Komunës së Klinës të datës 20 shtator 2010, janë regjistruar në emër të ndërmarrjes së re NEWCO Malishgan nga Klina, pasi që ndërmarrja shoqërore me të njëjtin emërtim është privatizuar.

- 8- Paraqitësit të kërkesës vendimi i KKKPK-së i është dorëzuar me 28 qershor 2013. Ndërkaq, i njëjti paraqiti ankesat me 18 korrik 2013.
- 9- Me ankesën e paraqitur kundër vendimit të KKKPK-së, ai pretendon se ky vendim është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave sikundër të drejtës procedurale ashtu edhe asaj materiale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj ,propozon që ky vendim të ndryshohet duke ia pranuar atij të drejtat pronësore mbi pronat e kërkuara. Me ankesën e paraqitur ai deklaron se aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Klinë, C.nr.319/96 datë 17 mars 1998 ,është i plotfuqishëm dhe se i njëjti është dashur të gjendet në Arkivin e kësaj Gjykate. Ai më tej pretendon se ndonëse, ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm në vitin 1998 por për shkak të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë nuk ka mundur të regjistrohet në regjistrat përkatës për regjistrimin e pronës së paluajtshme.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

- 10- Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, parashikon se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkëputura, kur për bashkimin apo shkëputjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkëputjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
- 11- Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parshohin mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribuon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

- 12- Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjtë në të 10 (dhjetë) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.
- 13- Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-197/13 deri 206/13, janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-197/13.

Pranueshmëria e ankesave:

- 14- Gjykata Supreme e Kosovës ,aktgjykimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se:
- 15- Ankesat janë të pranueshme ngase janë paraqitur mbrenda afatit ligjor sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079,ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin. Kjo për arsye se ,vendimi i është dorëzuar ankuesit me 28 qershor 2013 dhe se i njëjti me 18 korrik 2013 ka paraqitur ankesë.
- 16- Nga kjo gjendje e faktike me pamëdyshje rezulton se vendimi ankimor është marr me shkelje thelbësore nga neni nenet 194 dhe 182.2 b të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore për shkak të së cilale i njëjti është dashur ex officio të anulohet dhe kërkesat të hedhen për shkak se kërkesat e tilla janë jasht juridiksionit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave pronësore dhe rrjedhimisht kësaj Gjykate.
- 17- Kjo pikërisht për arsye se, sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, një paraqitës kërkesë ka ta drejtë në një urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën në pronësore por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
- 18- Sipas kësaj dispozite ligjore juridiksioni i KPPK-ës dhe Gjykatës Supreme është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërliken me konfliktin apo që janë si posojë e drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga ky konflikt. Paraqitësi i kërkesës nuk e konteston faktin se pronat e kërkuara kanë qenë të regjistruara në emër të Ndërmarrjes Prodhuese Bujqësore “Malishgan” nga Klina , por ai pretendon se nëna e tij ia ka shitur ato kësaj Ndërmarrjeje sipas kontratës Vr.nr.17/69 i datës 16.9.1969 e që në ndërkohë sipas

aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Klinë, C.nr. 319/96 i datës 17 mars 1998 ajo kontratë është anuluar.

- 19- Sipas fletë posedimit nr.198 të Drejtorisë për kadastrë, gjeodezi dhe pronësi të Komunës së Klinës, i datës 4.2.2008, ngastrat kadastrale të kërkuara nga paraqitësi i kërkesës të cilët gjenden në zonën kadastrale Shtupel, Komuna e Klinës kanë qenë të regjistruara në emër të ndërmarrjes së bujqësore prodhuese “Malishgan” nga Klina .Po kështu sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të Zyrës Kadastrale të Komunës së Klinës të datës 20 shtator 2010, këto prona duke qenë se ishin në emër të Ndërmarrjes bujqësore prodhuese “Malishgan” nga Klina të njëjtat në procesin e privatizimit nga AKP kanë kaluar në emër të NEWCO “Malishgan” toka bujqësore në Malishgan LL.C. (qirambajtjeje për 99 vjet).Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Klinë, C.nr. 319/96 i datës 17 mars 1998 nuk është i verifikuar si i vërtet pasi që nuk është gjetur në arkivin e kësaj gjykate.
- 20- Prandaj, rezulton me pa mëdyshje që paraqitësi i kërkesës jo vetëm se nuk dëshmoi të drejtën pronësore mbi këto prona por as edhe rrethanën se eventualisht humbja e këtyre provave nuk mund të ushtrohet për shkak të konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën prej vitit 1998/1999.
- 21- Duke qenë se tashmë sipas certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të datës 20 shtator 2010 rezulton se pronat e kërkuara janë regjistruar në emër të Ndërmarrjes NEWCO “Malishgan” toka bujqësore në Parallovë pasi që Ndërmarrja shoqërore është privatizuar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, atëherë paraqitësi i kërkesës mund t’i ushtrojë të drejtat subjektive në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit si Gjykatë kompetente lëndore dhe vendore sipas nenit 4 të Ligjit nr. 04/1-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ngase këto prona kanë qenë në emër të Ndërmarrjes bujqësore prodhuese “Malishgan” nga Klina si pronë shoqërore.
- 22- Kjo për më tepër ngase KKPK rrjedhimisht edhe gjykata Supreme është e kufizuar ekskluzivisht në kërkesat për vërtetimin e së drejtës pronësisë së paluajtshme private dhe kthimin e posedimit për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejt apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë 1998/1999.KKPK dhe rrjedhimisht Gjykata Supreme duke vendosur në këtë kolegji të apelit nuk ka juridiksion për të vendosur për çështjet që lidhen me pronën shoqërore të ndërmarrjeve shoqërore dhe rrjedhimisht procesit të privatizimit siç është rasti konkret.
- 23- Si rrjedhojë, kërkesat është dashur të hidhet poshtë për shkak se nuk ka qenë nën kompetencën e Gjykatës. Gjykata ,prandaj sipas nenit 198 par1 të LPK-ës anulon ex officio vendimin e KKPK-së dhe lëshon një vendim të ri që hedh poshtë kërkesën.
- 24- Ky aktgjykim nuk e përjashton të drejtën e paditësit për t’i referuar kërkesat të gjykatat kompetente jashtë juridiksionit të parashikuar me dispozitat e nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Këshillë ligjore:

Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it